Vrasja e gruas shtatzënë në oborrin e QKUK-së, i dyshuari ende në arrati

LAJME



01/12/2022 08:20

Një ngjarje e rëndë ka tronditur mbrëmë gjithë vendin.

Gruaja shtatzënë e cila po pritej të sillte në jetë foshnjën e saj, është vrarë mbrëmë në oborrin e klinikës Gjinekologjike në kuadër të QKUK-së.

35 vjeçarja, me inicialet H.M, nga Komuna e Lipjanit është vrarë nga personi i dyshuar, i cili ishte ish-bashkëshorti i saj.

E njëjta theksohet të ketë qenë në proces të divorcit, ndërsa i dyshuari në këtë rast shtiu tri herë radhazi mbi trupin e viktimës e cila po barte foshnjën që ishte paraparë të lindte sot.

Që nga orët e mbrëmjes Policia e Kosovës është në kërkim të të dyshuarit në këtë rast, S.M nga Shtimja.

Si fillim Policia konfirmoi rastin ndërsa u theksua se janë duke vazhduar hetimet në lidhje me këtë rast.

"Rreth orës 18:00, kemi pranuar informatën për një trup të pajetë, në oborrin e QKUK-së në Prishtinë. Policia menjëherë ka dalë në vendin e ngjarjes si dhe ekipi mjekësor të cilët kanë konstatuar vdekjen e viktimës, femër, rreth 35 vjeç. Mbështetur në informacionet e para, dyshimet e ngritura sugjerojnë se bëhet fjalë për vrasje", ka deklaruar Ahmeti.

Duhet përkujtuar që identifikim i të dyshuarit në këtë rast tashmë është bërë, teksa Policia e Kosovës është në kërkim të tij.

Ndryshe disa nga familjarët e viktimës të cilët janë deklaruar mbrëmë para mediave kanë bërë të ditur se çifti kanë pasur probleme edhe më herët.

E njëjta e kishte raportuar të dyshuarin edhe më parë në Policinë e Kosovës, ndërsa nga Gjykata ishte vendosur që ajo të jetë nën mbrojtje dhe që i dyshuari të qëndrojë larg saj.

Pavarësisht kësaj, gjatë kohës sa ajo kishte dalë për shëtitje jashtë objektit të Gjinekologjisë në QKUK, i njëjti i është afruar ku edhe i mori jetën asaj dhe foshnjës, që sot pritej të vinte në jetë./**Lajmi.net/**



LAJME TË FUNDIT

Haxhiu: Pacientja 35 vjeçare është vrarë mbrëmë në duart e mjekëve

Szczesny pret dënim nga FIFA për të dhe...

Presidenti gjerman mbërrin në Tiranë, pritet nga presidenti Begaj

Juventusit i hapet rruga për transferimin e Marco Asensio

Artikuj të ngjashëm

December 1, 2022
Presidenti gjerman mbërrin në Tiranë, pritet nga presidenti Begaj

December 1, 2022
Opozita kërkon dorëheqje të udhëheqëve të disa dikastereve pas rastit të...


December 1, 2022
Mbahet seanca e Apelit në çështjen Gucati e Haradinaj

December 1, 2022
Vidhen barna në depo të Ministrisë, arrestohen dy persona

December 1, 2022
Kurti emëron Nenad Rashiqin si Ministër për Komunitete dhe Kthim

December 1, 2022
Gexha shpreh ngushëllime për vrasjen e shtatzënës mbrëmë në QKUK

©Copyright lajmi.net 2022. All Rights Reserved Privacy Policy